

2. KQZ- 09/2019 Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike

Grada/Koeficienti:	Niveli Drejtues- ND - G2 / K- 19.35
Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë:	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Kohëzgjatja e emërimit:	Me afat të caktuar
Vendndodhja :	Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës

1. Përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të zyrës.
2. Siguron që funksionet e zyrës të zbatohen në përputhje me akte ligjore, nënligjore në fuqi dhe vendimet e KQZ-së;
3. Përgatit raporte dhe i rekomandon KQZ-së;
4. Koordinon aktivitetet me Sekretariatit e KQZ - së dhe PZAP-in;
5. Mbikëqyrë, hartimin e akteve nënligjore që kanë të bëjnë me Zyrën dhe bën planin për aktivitetet e punës së Zyrës;
6. Këshillon dhe udhëzon subjektet politike lidhur me obligimet ligjore ndaj KQZ-së;
7. Përfaqëson Zyrën brenda dhe jashtë institucionit;
8. Menaxhon punët dhe stafin e Zyrës;
9. Detyra dhe përgjegjësi të tjera që i caktohen nga KQZ-ja;

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

1. Diplomë Universitare në Drejtësi, Administratë publike, Shkenca Politike;
2. Diplome universitare dhe së paku gjashtë (6) vite përvojë pune duke përfshirë katër (4) vite përvojë menaxheriale.
3. Integritet të lartë personal dhe profesional
4. Shkathtësi të shkëlqyeshme për hartim dhe shprehje me shkrim
5. Aftësi dhe gatishmëri për të punuar me njerëz të përkatësive të ndryshme kulturore dhe etnike;
6. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare e obligueshme;
7. Njohje e gjuhës angleze e dëshirueshme;
8. Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access).

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Personelit, dhoma nr. 21, kati I-rë, Ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës,, Rruga "Migjeni" 10000 Prishtinë. Aplikacionet mund të dorëzohen edhe në formë elektronike të skenuara në adresën elektronike: zyra.personeli@kqz-ks.org.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në numrin e tel: 038-200-23-557, prej orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KQZ-së, në linkun: www.kqz-ks.org. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurren, certifikatën që nuk jeni nën hetime si dhe dy formularët e fundit të vlerësimit nga institucioni ku keni punuar. Kandidatët që aplikojnë për këtë pozitë, japin pëlqimin e tyre (nëse kandidati/ja konsiderohet i/eemërueshem) që emrat dhe rezultatet e tyre të intervistës, do të publikohen në websiten e projektit të rekrutimit Britanik. Kandidatët të cilën hyjnë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit nga zyra e personelit. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor, prej datës: 20 prill 2019 deri me datë: 04 maj 2019 në ora 16:00. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.